

AKTI I THEMELIMIT  
I  
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ALBANIAN MEDICINE" SH.P.K.

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

**Z. EKREM AKTUG**, i datelindjes 27.03.1968, i biri i Sevket-it, lindur ne Akcaabat/ Turqi dhe banues ne Turqi, Damlar Mah. Kocaorman Cd. No:130/3C1, Bas iskele, Kocaeli, Turqi, Shtetas turk mbajtes i pasaportes me nr. S20333877 madhor, me nr personal 23897585030 me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Z. EROL AKTUG**, i datelindjes 05.01.1971, lindur ne Trabzon/Turqi , i biri i Sevket`it , banues ne Turqi , Cinarli Koyu 7 Sk, Dardanos mevki, Dardania park evleri, EB/1D Merkez ilce, Canakkale, Turqi, shtetas turk, mbajtes i pasaportes me nr. U25316102, madhor, me nr personal turk 23888585322 me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Z. EMIN MURTEZA DURMUS**, i datelindjes 26.04.1969, lindur ne Akcaabat/Turqi , i biri i Idris`it, banues ne Hollande, shtetas hollandez, mbajtes i pasaportes me nr. NN7755BK3, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Z. TANER AKDAMAR**, i datelindjes 01.01.1973, lindur ne Turqi, i biri i Ahmet`it , banues ne Shqiperi, Rruga Muhamet Deliu, Pll. Merkaj Kati 3/10, Fresku, Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes me nr. BC7570695, madhor, me nr personal H30101727P, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

**Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise "ALBANIAN MEDICINE" SH.P.K.**

Sot me date **30.08.2022**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

**Kreu I**

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

**Neni 1**

**Objekti i shoqerise**

Shoqeria Tregtare "ALBANIAN MEDICINE" SH.P.K, ka si objekt veprimtarie:

- 1- Themelimi, menaxhimi i klinikave, poliklinikave, imazheri dhe laboratore. Import - Eksporti, tregtimi i te gjitha pajisjeve mjekesore, mallrave mjekesore, proteza, merrja dhe dhenja e tyre me qera etj.
- 2- Blerje dhe shitje e ilaceve dhe medikamenteve mjekesore.
- 3- Sherbim konsultor brenda apo jashte vendit me te gjitha institucionet qe kryejne aktivitet ne kete fushe, per mjekime apo diagnostifikime. Ndermejtsime neper qendra te tjera te tjera si dhe leshim/krijim i agjensive.
- 4- Mjekesia dhe Siguria ne pune. Trajnime dhe licensime.
- 5- Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, t'i marre ose t'i leshoje me qera, te marre tenderin e tyre. Mund te vendose pasuri te

luajtshme dhe te paluajtshme, t'a hipotekoje kete pasuri ne regjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj.

**6-** Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejttat e tjera qe jane te ngjashme me keto.

**7-** Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj., ne lidhje me keto fusha

## **Neni 2**

### **Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise**

Ortaket vendosen qe shoqerine t'a emertojne "ALBANIAN MEDICINE" SH.P.K.

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Njesia Administrative Nr.4, Rr. "Kongresi Manastirit" Nr.19/3, Tirane

Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## **Neni 3**

### **Forma Juridike**

Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi

Me vendim te ORTAKEVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.

Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.

Shoqeria do te kete vulen e saj.

## **Kreu II**

### **TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA**

## **Neni 4**

### **Te drejttat e Shoqerise dhe te Ortakeve**

Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.

Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

## **Neni 5**

### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

**Kreu III**  
**KAPITALI THEMELTAR**

**Neni 6**

**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. E ndare ne 4 (kater) kuota.

**Ortaket e shoqerise jane:**

**EKREM AKTUG**, zotërues i **30% (tridhjete) te kuotave** të kapitalit të shoqërisë;

**EROL AKTUG** zotërues i **30% (tridhjete) te kuotave** të kapitalit të shoqërisë;

**EMIN MURTEZA DURMUS** zotërues i **30% (tridhjete) te kuotave** të kapitalit të shoqërisë;

**TANER AKDAMAR** zotërues i **10% (dhjete) te kuotave** të kapitalit të shoqërisë;

**Kreu IV**

**PERSONALITETI JURIDIK**

**Neni 7**

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

**Kreu V**

**ADMINISTRIMI**

**Neni 8**

Shoqeria do te administrohet nga administratori **TANER AKDAMAR**, e cila perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.

Administratori mund t'i delegeje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

**Kreu VI**

**DISPOZITA TE TJERA**

**Neni 9**

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise.

Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 4 (kater) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.

Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAKET THEMELUES**

**EKREM AKTUG**

*EKREM AKTUG*  
*[Signature]*

**EROL AKTUG**

*[Signature]*  
**Erol Aktug**

**EMIN MURTEZA DURMUS**

*Emin Murteza Durmus*  
*[Signature]*

**TANER AKDAMAR**

*Taner Akdamar*  
*[Signature]*

*[Signature]*